



9 Janar 2015, Prizren

THIRRJE PËR OFERTIM
Kompani për përkthimin e produkteve në gjashtë gjuhë

OJQ EC Ma Ndryshe me seli në Prizren ka nisur zbatimin e projektit “Zhvillimi rajonal përmes turizmit kulturor në Prizren”. Në kuadër të këtij projekti, do të hartohen: një katalog i trashëgimisë kulturor të rajonit Jug; dhe pesë guida/pako turistike të rajonit të Prizrenit. Për përkthimin me shkrim të këtyre produkteve turistike nga gjuha shqipe në gjashtë gjuhë të tjera (serbisht, turqisht, anglisht, frengjisht, gjermanisht dhe italisht), EC Ma Ndryshe do të përzgjedh një kompani profesionale të përkthimeve, për çka ju ftojmë që të dërgoni ofertën tuaj bashkë me dokumentet përcjellëse.

Detyrat dhe përgjegjësitë

Kompania e përzgjedhur e përkthimeve do t’i përkthejë me shkrim të gjitha produktet turistike të projektit (katalogu i rajonit Jug dhe pesë guidat/pakot turistike) nga gjuha shqipe (origjinali) në gjashtë gjuhë të tjera (serbisht, turqisht, anglisht, frengjisht, gjermanisht dhe italisht). Kompania duhet të ofrojë përkthim profesional të standardeve të larta gjuhësore, gramatikore dhe sintaksore, pasi që produktet targetojnë audiencat ndërkombëtare. Në momentin e marrjes së produkteve në gjuhën origjinale (shqip) nga EC Ma Ndryshe, kompania e përkthimeve duhet të nisë përkthimet në të gjashtë gjuhët në mënyrë paralele, për t’u siguruar në përfundim të shpejtë të angazhimit.

Kriteret e përzgjedhjes

Gjatë shqyrtimit të ofertave, EC Ma Ndryshe do të ketë për bazë këto kriteret të përzgjedhjes:

- Çmimi i volitshëm,
- Përvoja e kompanisë në përkthime (sidomos në gjuhët e kërkuara),
- Stafi permanent dhe bashkëpunëtorët e jashtëm (përkthyesit),
- Referencat nga klientët (opsionale).

Aplikimi

Për të ofertuar për shërbime të përkthimit, ju lutem dërgoni ofertën tuaj financiare në email adresën info@ecmandryshe.org dhe shkruani në *subject* “Ofertë për shërbime të përkthimit”, më së largu deri më 19 Janar 2015, në orën 15.00. Aplikacionet që vijnë pas këtij afati dhe ato që nuk i përmbajnë dokumentet relevante, nuk do të konsiderohen. Oferta duhet të përmbajë çmimin e përkthimit për fjalë, për të gjitha gjashtë gjuhët veç e veç (nga shqip në serbisht, turqisht, anglisht, frengjisht, gjermanisht dhe italisht), në përjashtim të rasteve kur çmimi është i njëjtë për të gjitha gjuhët. Bashkë me ofertën tuaj financiare, ju lutem bashkëngjitni edhe këto dokumente: çertifikata e regjistrimit, çertifikata e numrit fiskal, çertifikata e TVSh-së, dëshmi të përkthimeve të mëhershme (në fusha të ngjashme) dhe CV-të e së paku dy përkthyesve për gjuhë të ndryshme.

Pas vlerësimit fillestar të ofertave, EC Ma Ndryshe rezervon të drejtën të kërkojë dokumente (dëshmi) shtesë nga kompanitë nëse e vlerëson të nevojshme (përfshi edhe përkthimin testues në gjashtë gjuhët). EC Ma Ndryshe rezervon të drejtën për të negociuar ofertën financiare. Për më shumë informacione rreth thirrjes për aplikim, ju lutemi vizitoni www.ecmandryshe.org/konkurse.

Projekti “Mbështetje për sektorin e turizmit në Rajonin Ekonomik Jug”, përkrahjet financiarisht nga Ministria për Punëve të Jashtme të Finlandës në suaza të projektit “Ndihmë Tregtisë”, implementuar nga Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP).